

VENDIM
Nr. 487, datë 12.6.2013

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRIT PËR INOVACIONIN DHE TEKNOLOGJINË E
INFORMACIONIT E TË KOMUNIKIMIT PËR NEGOCIMIN DHE NËNSHKRIMIN E RINOVIMIT
TË MARRËVESHJES SË PARTNERITETIT STRATEGJIK, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË “MICROSOFT
CORPORATION”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 27 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, të ligjit nr. 8838, datë 22.11.2001 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin e OBPI-së “Për të drejtën e autorit””, të ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, dhe të nenit 10 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit për negocimin dhe nënshkrimin e rinovimit të marrëveshjes së partneritetit strategjik, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë “Microsoft Corporation”.

2. Kostot financiare për realizimin e marrëveshjes së partneritetit strategjik në fushën e teknologjisë së informacionit mbulohen nga Buxheti i Shtetit.

3. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Ministri i Financave dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha